

TË DREJTAT E KONSUMATORIT

KLIENTI FUNDOR KA TË DREJTË:

1. Të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e vendosura në kontratë;
2. Të paraqesë ankesë pranë përfaqësive të furnizuesit dhe pranë ERE-s, nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë;
3. Të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;
4. Të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit në përputhje me kontratën;
5. Të drejtën për të zgjedhur dhe ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi ka ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;
6. Të marrë informacion të plotë, me shkrim, për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;
7. Të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;
8. Të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit;
9. Të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, përfshirë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi;
10. Të informohet, pa kosto shtesë, për konsumin e tij dhe kostot respektive të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur klienti;
11. Klientet kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.